LIGJ
Nr. 36/2018

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 7918, DATË 13.4.1995, "PËR MIRATIMIN ME NDRYSHIME TË DEKRETIT NR. 1030, DATË 23.2.1995, "PËR EMETIMIN DHE SHPËRNDARJEN E BONOVE TË PRIVATIZIMIT (LEKË PRIVATIZIMI)" DHE DEKRETIT NR. 1049, DATË 27.3.1995, "PËR DISA PLOTËSIME NË DEKRETIN NR. 1030, DATË 23.2.1995, "PËR EMETIMIN DHE SHPËRNDARJEN E BONOVE TË PRIVATIZIMIT"", TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr. 7918, datë 13.4.1995, "Për miratimin me ndryshime të dekretit nr. 1030, datë 23.2.1995, "Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekë privatizimi)" dhe dekretit nr. 1049, datë 27.3.1995, "Për disa plotësime në dekretin nr. 1030, datë 23.2.1995, "Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit"", të ndryshuar", fjalia e fundit e nenit 3 ndryshohet si më poshtë:

"Afati i përdorimit të bonove dhe lekëve të privatizimit është deri më 31.12.2021.".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 21.6.2018

Shpallur me dekretin nr. 10821, datë 28.6.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta